

## Bisedë me psikologun?

Njerëzit që ndodhen në një situatë të vështirë jetësore mund të kenë nevojë për ndihmë të llojeve të ndryshme. Njëra prej këtyre ndihmave është trajtimi te psikologu.

### Çka është psikologu?

Psikologu është një ekspert me 6-7 vjet shkollim univërzitar, në shumë raste ai ka edhe specializim pasunivërzitar. Titulli psikolog është një titull i mbrojtur, që do të thotë se vetëm personat me këtë shkollim përkatës mund ta quajnë veten psikolog në Norvegji. Psikologët kanë njohuri të veçanta për ndjenjat e njeriut dhe reagimet si pasojë e ndjenjave. Psikologët gjatë punës së tyre punojnë me shumë pjesë të ndryshme të jetës, por njëra nga punët kryesore është puna me njerëz me probleme psikike si pasojë e situatës së tyre jetësore.

### Si punon psikologu?

Psikologu bazohet në metoda të pranura shkencore për të hulumtuar dhe trajtuar problemet psikike të fëmijëve dhe të të rriturve. Përmes bisedave rreth temave të vështira psikologu kërkon t'i zbuloj neveritjet e lidhura me kujtesa të dhimbshme, me mendime dhe ndjenja, ku psikologu dhe kërkuesi i ndihmës bashkërisht mundohen ti gjejnë strategjitë më të mira të zotërimit të situatës aktuale jetësore. Psikologu mund të ndihmon familjet për t'i ndryshuar modelet negative të bashkëjetesës në familje. Psikologu nuk jep barna, por shpesh bashkëpunon me mjekun për përdorim eventual të barnave.

Psikologu nuk bën biseda me persona që dëshirojnë ndihmë për qëllime praktike siç janë kërkesat për vertetim për shpërngulje, banesë të re ose gjëra të ngjashme.

### Ruajtja e sekretit

Psikologët janë të obliguar ta ruajnë sekretin e punës së tyre. Kjo do të thotë se çka flitet me psikologun, nuk i tregohet askujt, as të tjerëve në familje, as entit shëndetësor, as shkollës, as entit social ose policisë, pa pranuar ai që kërkon ndihmë. I vetmi përjashtim për ruajtjen e sekretit është nëse fëmijët vuajnë seriozisht nga ngarkesa, ose nëse jeta e ndonjë personi është në rrezik.

### Përkthyesi

Është shumë vështirë të flasësh për ndjenja në një gjuhë tjetër përpos asaj amtare. Për këtë arsye përdorimi i përkthyesit mund të jetë i dobishëm edhe pse kërkuesi i ndihmës ka mësuar diçka norvegjisht. Edhe përkthyesi është i obliguar ta ruajë sekretin për atë që flitet në biseda